



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 3123 Prot.

Tiranë, më 12.05. 2020

URDHËR

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË FSDKSH GJATË GJENDJES SË EPIDEMISË SË
SHKAKTUAR NGA COVID-19”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit nr. 243, datë 24.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, i ndryshuar, Urdhrit nr.156, datë 10.03.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për marrjen e masave të vecanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së FSDKSH gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, sipas rregullore të miratuar me këtë urdhër.
2. Kjo rregullore është e vlefshme deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, dhe rishikohet apo dhe ndryshohet në raport me vijueshmërinë e saj.
3. Ngarkohen Drejtoria Qendrore e FSDKSH, Drejtoritë Rajonale, Degët/Agjensitë e Fondit, për zbatimin e rregullore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rudina Degjoni

